



USAID dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës fuqizojnë bashkëpunimin dhe koordinimin në interes të pushtetit lokal në Kosovë

në këtë numër:

- 3 **AKK-ja koordinon aktivitetet vjetore me DEMOS-in**
- 4 **Debatohen dy Udhëzime Administrative në takimin e përbashkët të dy Kolegjiumeve të AKK-së**
- 8 **Kryesuesit e Kuvendeve të Komunave identifikojnë nevojat për këshilltarët e ardhshëm komunal**
- 8 **Plan pune për fuqizimin e Transparencës nëpër Komunitet e Kosovës**

KRYETARËT E KOMUNAVE debatuan Ligjin për sigurime Shëndetësore, Prokurimin Elektronik, Pagesat e kundërvajtjeve mandatore dhe ndëshkimet për mbeturina



AKK dhe Ministria e Jashtme organizuan konferencën për Diplomacinë e Qyteteve

Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme si vazhdimësi e Konferencës së Ambasadorëve të vitit të kaluar, organizuan Konferencën tematike me temën “Diplomacia e Qyteteve: Qeverisja, zhvillimi lokal dhe marrëdhëniet me jashtë”.

Qëllimi i kësaj konference ishte që të diskutohet me kryetarët e komunave të Kosovës, diplomatët e Kosovës dhe të huaj dhe ekspertë të fushës të analizohen aktivitetet në mënyrë që të shfrytëzohen të gjitha dimensionet e Diplomacisë së Qyteteve dhe bashkëpunimi me Misionet Diplomatike të Kosovës për avancim në qeverisje, zhvillim lokal dhe mbi të gjitha për përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Në këtë takim me fjalë rasti janë paraqitur ministri i Punëve të Jashtme z. Enver Hoxhaj dhe kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z. Naim Ismajli. Po ashtu është bërë edhe prezantimi në temën “Bashkëpunimi ndërkufitar i qyteteve në tërheqjen e donacioneve”.



KRYETARËT E KOMUNAVE debatuan Ligjin për sigurime Shëndetësore, Prokurimin Elektronik, Pagesat e kundërvajtjeve mandatore dhe ndëshkimet për mbeturina



Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka organizuar takimin e Këshillit të Kryetarëve e ku mori pjesë edhe Ministri i Shëndetësisë z.Imet Rahmani, z.Safet Hoxha – Kryetar i Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës z.Çlirim HajdiniJuridike, z.Haxhi Krasniqi - Shef i Sektorit për Hartimin dhe Harmonizimin e Akteve Normative dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Takimin e hapi kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli i cili tha se para kryetarëve të komunave kemi ftuar përfaqësuesit e institucioneve qendrore për të debatuar me tri çështje që janë mjaft të rëndësishme për momentin.

Ministri i Shëndetësisë, z.Imet Rahmani, deklaroi se janë duke kryer përgatitjet që nga korriku i këtij viti, sipas vendimit të Qeverisë, të fillohet me mbledhjen e premiumeve për sigurimin shëndetësor. Poashtu ai përmendi edhe ndryshimet legjislative që janë në proces, ndërkohë që ka numëruar edhe përfitimet e para që pritet t'i gëzojnë qytetarët pas fillimit të mbledhjes së premiumeve.

Ministri z.Rahmani tha se është në proces të finalizimit të listës së

barnave jashtë spitalore që qytetarët të cilët paguajnë premiumin shëndetësor do të marrin falas në barnatore dhe të cilat do të rimbursohen nga Ministria, ndërkohë që përfitimi i tretë pritet të jetë furnizimi i rregullt dhe i plotë i QKUK-së dhe spitaleve të përgjithshme me barna dhe material shpenzues.

Kryetarët e Komunave shtruan disa çështje për diskutim me ministrin Rahmani si kush është i autorizuar të hartoj listën e të varfërve për t'u liruar nga këto pagesa, cila është kudërvlera në shërbime mjekësore, rreziku i keqpërdorimeve të shërbimeve nga ky fond etj., të cilat morën përgjigje nga ia pari i Ministrisë së Shëndetësisë.

Pastaj, Kryetari i Komisionit

Rregullativ për Prokurimin Publik z.Safet Hoxha, bëri një elaborim të funksionimit të sistemit të prokurimit publik, si një nga segmentet e instaluar për më shumë transparencë në shfrytëzimin e parasë publike.

Pas debatit me kryetarët dhe shqetësimeve të tyre për problemet në funksionimin e tij në këtë fazë, me insistimin e kryetarëve KRPP-ja u zotua se edhe këtë javë do të vendoset nëse do të eliminohen blerjet e mesme me anë të këtij sistemi (do të mbesin vetëm blerjet mbi gjysmë milioni euro) apo do të vazhdojë edhe një kohë siç ka qenë për shkak të zgjatjes së procedurave dhe pamundësisë së implementimit të tij në këtë fazë.

Kryetarët e Komunave në pjesën tjetër të këtij takimi debatuan me përfaqësuesit e Policisë së Kosovës lidhur me gjobat e trafikut- pagesat e kundërvajtjeve mandatore si dhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me ndëshkimet dhe gjobat mandatore – për mbeturinat.

USAID dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës fuqizojnë bashkëpunimin dhe koordinimin në interes të pushtetit lokal në Kosovë

Me qëllim të njoftimit më për së afërmi me aktivitetet e AKK-së si dhe në mënyrë që këto aktivitete të bashkërendohen në pesë (5) vitet e ardhshme, sot Asociacionin e Komunave të Kosovës e vizitoi z.Stephen Carpenter - Shef i Zyrës së projektit USAID Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM).

Në këtë takim Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim, njoftoi z.Carpenter rreth organizimit, punës dhe aktiviteteve të AKK-së të cilat bëhen me



qëllim të avancimit të pushtetit lokal në Kosovë.

z.Carpenter në emër të projektit të mbështetur nga USAID, sqaroi rëndësinë e këtij projekti si dhe u zotua për një bashkëpunim të ngushtë me AKK-në

për çështjet të cilat kanë të bëjnë me komunat, konkretisht duke ofruar bashkëpunim të drejtëpërdrejt me disa Kolegjiume relevante të AKK-së, e veçanarisht duke ofruar përkrahje për Kolegjiumin e sapo formuar pranë AKK-së të Menaxherëve të Prokurimit të Komunave.

Takimet do të jenë të vazhdueshme dhe do të fuqizohet bashkëpunimi me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve për pushtetin lokal.



AKK-ja koordinon aktivitetet vjetore me DEMOS-in

Asociacioni i Komunave të Kosovës mbajti takim koordinues me stafin e DEMOS/Helvetas i cili mbështetet nga SDC-ja.

Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim dhe Drejtori i Programit DEMOS/Helvetas z.Norbert Pijls theksuan se takime të tilla koordinues janë të rëndësishme si për vetë organizatat ashtu edhe për pushtetin lokal në Kosovë.

Në këtë takim, i cili tashmë është vjetor, u paraqiten planet vjetore



për vitin 2017 të Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe të DEMOS/Helvetas.

Pas paraqitjeve të planeve vjetore, janë identifikuar aktivitetet dhe projektet në të cilat dy organizatat, që merren me qeverisjen lokale në vend, të bashkëren-

dojnë veprimet e tyre në mënyrë që produktet për komunat të jetë më kuptimplotë dhe gjithëpërfshirës. Poashtu në këtë takim është bërë edhe konsolidimi i qëndrimeve për disa nga çështjet e rëndësishme që ndërlidhen me qeverisjen lokale në Kosovë.

Delegacioni i AKK-së mori pjesë në Kongresin e Autoriteteve Lokale të Këshillit të Evropës

Autoritetet Lokale të Kosovës përmes një delegacioni të Asociacionit të Komunave të Kosovës (z.Naim Ismajli - kryetar, z.Agim Veliu – nënkryetar, z.Gradimir Mikiq – anëtar i Bordit dhe z.Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së) kanë përfaqësuar në Kongresin e Autoriteteve Lokale të Këshillit të Evropës në Strasburg, në kuadër të sesionit pranveror.

Gjatë këtij sesioni delegacioni i komunave të Kosovës do të takohet me shumë përfaqësues të pushteteve lokale nga Evropa.

Takimet do të fokusohen rreth çështjeve që kanë të bëjnë me funksionimin e pushtetit lokal, ngritjes së kapaciteteve, shkëmbimit të përvojave dhe implementimi i Kartës Evropiane mbi Vetëqeverisje Lokale. Vlen të ceket se Asociacioni i Komunave të Kosovës është anëtar vëzhgues në Kongresin e Autoriteteve Lokale të Këshillit të Evropës dhe aty përfaqëson komunitetet e Kosovës.



Debatohen dy Udhëzime Administrative në takimin e përbashkët të dy Kolegjiemeve të AKK-së



Në kuadër të koordinimit të aktiviteteve në interes të Komunave, Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor dhe Kolegjiumi për Inspeksion mbajtën takimin e përbashkët me qëllim diskutimin dhe harmonizimin e qëndrimeve në projekt udhëzimet e reja administrative: 1) Projekt Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore si dhe për

leje ndërtimore për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve; 2) Projekt Udhëzimin Administrativ për mbikëqyrje inspektive dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Këto dy akte nënligjore kanë një ndikim direkt në punën e komunave sa i përket inspektimit dhe lëshimit të lejeve ndërtimore.

Qëllimi i këtyre udhëzimeve administrative është përcaktimi i procedurave për përgatitjen dhe

shqyrtimin e kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrëtimi, për shkak të reformave të përgjithshme në lehtësimin e mjedisit për të bërë biznes, duke përfshirë këtu edhe reformat në lëshimin e lejeve ndërtimore. Për më tepër, Banka Botërore me raportin e saj për "Doing Business" ka paralajmëruar ndryshime në disa indikatorë, një prej të cilëve e adreson fushën e ndërtimit në përgjithësi dhe identifikon nevojën për përmirësimin e procesit të lëshimit të lejeve të ndërtimit. Përfaqësuesit Komunal kanë kërkuar që pjesë të caktuara të këtyre U.A. të sqarohen me qëllim të thjeshtësimit të mëtutjeshëm të kërkesave ligjore, afatëve kohore dhe minimizimit të kostos, ku me zbatimin e koncepteve të reja marrja e lejes ndërtimore do të jetë shumë më e lehtë dhe më e shpejtë.



“Analiza e boshllëqeve në sektorin e mbeturinave në Kosovë”

Në kuadër të bashkëpunimit në interes të autoriteteve tona lokale, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe projekti DEMOS kanë prezantuar studimin “Analiza e boshllëqeve në sektorin e mbeturinave në Kosovë”. Në këtë prezantim me shumë

rëndësi për komunat e Kosovës me theks në fushën e shërbimeve publike, janë paraqitur rezultatet dhe veprimet që komunat duhen t’i ndërmarrin për të përmirësuar cilësinë e shërbimit të mbeturinave. Kjo analizë do të lehtësojë punën e komunave në fushën e shërbimeve publike lidhur me mbeturinat në mënyrë që kjo sferë me rëndësi në qeverisjen lokale të kapërcejë pengesat drejtë shërbimeve sa më efikase dhe cilësore.

Gjatë këtij sesi u prezantua edhe “Udhërrëfytesa tentativ për tenderimin e menaxhimit të mbeturinave” të përgatitur nga z.Felix Schmidt, ekspert i projektit DEMOS.



Debatohet Udhëzimi Administrativ për Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor

Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale mbajti takimin e rregullt të saj në vazhdim të angazhimit në diskutimin dhe harmonizimin e qëndrimeve në projekt udhëzimet e reja administrative. Si rezultat i bashkëpunimit të Kolegjiumit dhe gatishmërisë së Ministrit të Shëndetësisë z.Imet Rrahmani, ishte edhe diskutimi i Udhëzimit Administrativ për organizimin, përcaktimin e shërbimeve dhe veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH).

Të gjitha sugjerimet u përqendruan në respektimin

e kompetencave komunale dhe ngritjen e kapaciteteve si përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre.

Po ashtu në partneritet me Organizatën për fëmijët pa kujdes prindëror (OFAP), u ra dakord formimi i grupit punues me synim diskutimin dhe gjetjen e alternativave në krijimin e model rregullores me vëmendje të posaçme për rimbursim të medikamenteve për fëmijët pa kujdes prindëror e që janë në strehim familjar.

Raporti tremujor i Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor

Kolegjiut i Zyrtarëve Ligjor në takimin e fundit ka bërë bilancin e punës tremujore të këtij viti dhe ka debatuar për nevojën e hartimit të disa model - rregulloreve të reja komunale.

Si edhe deri më tani, ku Kolegjiut harton mode-rregullore të komunës, e të cilat janë të nevojshme dhe plotësojnë infrastrukturën ligjore komunale. Në këtë vit i është dhënë prioritet fushës së shërbimeve publike andaj kolegjiut propozojë tri model rregullore: a) model-rregullore për parkingje; b) model-rregul-



lore për menaxhimin e tregjeve; dhe c) model-rregullore për menaxhimin e varrezave, ku kjo e fundit do të hartohet e para meqë është e kërkesë dhe nevojë akute e komunave.

Ndërsa në pjesën e punës së bilancit tremujor të Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor për vitin 2017, u tha se janë diskutuar e rekomanduar aktet që janë më me rëndësi për funksionimin e komunave.

Diskutimi i draft dokumentit për financat lokale

Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi debatet me Kolegjiutet përkatëse sikurse është ai për Buxhet dhe Financa, Arsim si dhe Shëndetësi e Mirëqenie Sociale në diskutimin e draft koncept dokumentit për financat e pushtetit lokal si një dokument shumë i rëndësishëm, në mënyrë që komunat të mund të ushtrojnë kompetencat dhe realizojnë aktivitetet e tyre në mënyrë efikase dhe efektive. Në bazë të diskutimeve me përfaqësuesit komunal dhe me kërkesat e tyre lidhur me funksionimin në praktikë të funksioneve komunale, bëhet e nevojshme ndërhyrja në legjislacion të financave të pushtetit lokal për të zgjidhur në mënyrë të qëndrueshme funksionet dhe aktivitetet që mundësojnë efikasitet sa më të lartë në fushën e financave lokale.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij dokumenti lidhur me decentralizimin fiskal si dhe ndikimin në të ardhmen në planifikimet buxhetore komunale, komentet dhe rekomandimet e identifikuar nga ana e përfaqësuesve komunal në këtë proces konsultativ në veçanti ishin të përqendruara sa i përket ndryshimeve në: rregullimit dhe përfaqësimit më të mirë të interesave të komunave në Komisionin e Granteve (ndryshime në përbërjen dhe përgjegjësitë e Komisionit); krijimin e grantit specifik social; krijimin e fondit të përbashkët për përkrahjen e projekteve për investime kapitale për komuna; si dhe rishikimin e kriterëve për grantin e përgjithshëm, arsim dhe shëndetësi.

Kolegjiut i Udhëheqësve të Personelit

Në kuadër të aktiviteteve të saj, Asociacioni i Komunave të Kosovës organizuan takimin e Kolegjiut të Udhëheqësve të Personelit me qëllim diskutimin dhe harmonizimin e qëndrimeve në projekt rregulloret e reja administrative: 1) projekt rregullore për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, 2) projekt rregullore për procedurat disiplinore në shërbimin civil, 3) projekt rregullore për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave. Qëllimi i këtyre projekt rregulloreve është përcaktimi i rregullave dhe procedurave unike të rekrutimit; përcaktimi dhe klasifikimi i shkeljeve të detyrave të punës, procedurave disiplinore dhe masave që duhet të shqiptohen; si dhe vendosja masave në zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në marrëdhëniet e punës së nëpunësve civil. Udhëheqësit e Personelit në komuna gjatë diskutimit të këtyre dokumenteve përmes komenteve dhe sugjerimeve kanë kërkuar qartësimin e hollësishëm të procedurave, mos lejimin e dualizmave dhe keqinterpretimin e tyre si masë e domosdoshme në përcaktimin e një sistemi efikas të menaxhimit administrativ me qëllim organizimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, efikas dhe profesional.

Shkurtimisht

- AKK-ja, respektivisht Kolegjiumi i Integrimi Evropian ka shqyrtuar projekt-rregullore nr. xx/2017 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores (mie) nr. 01/2016 për subvencionimin e projekteve dhe aktiviteteve që promovojnë procesin e integritimit evropian të Republikës së Kosovës” dhe i ka dërguar rekomandimet në Ministrin e Integrimi Evropian
- AKK-ja mori pjesë në debatin publik të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri të Kuvendit të Kosovës për Projekt-Ligjin për Shoqëritë Tregtare
- AKK-ja është anëtar në këshillin organizativ për Ditën e Tokës 22 prillit, po merr pjesë në takime pune për koordinimin e aktiviteteve mes nivelit qendror dhe nivelit lokal
- AKK-ja mori pjesë në takimin e organizuar nga OSBE-ja (7 prill) me komunat, lidhur me temën e banimit social në Kosovë, ku si rekomandim doli që në të ardhmen të kërkohet të shtohet nënkodi buxhetor për banim si dhe pozita e punës së zyrtarit për banim
- Përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në takimin (13 prill) e Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Mandate, Imunitete, për debatin publik për Projektligjin për Trashëgimin, ku u propozuan disa amendamente të reja, si rezultat i vet komisionit parlamentar dhe organizatave tjera
- AKK-ja mori pjesë në takimin e parë punues (20 prill) në kuadër të projektit rajonal “ngritja e rrjetit për forcimin e aftësive ripërtëritëse urbane nga fatkeqësitë në Evropën Juglindore” AKK-ja mbajti takimin (21 prill) e radhës së Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor, ku u diskutuan të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të cilat janë hartuar në periudhën shkurt- mars 2017- impakti që do të kenë në komuna, si dhe formoj grupin punues për hartimin e “model-rregullores për shërbime publike”
- AKK-ja po përkrah Projektin DEMOS, me pjesëmarrje organizimin e në punëtorive në kuadër të aktiviteteve për fuqizim të gruas në politikë. Punëtoritë kanë si qëllim përkrahjen e gruas para dhe gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale gjatë këtij viti. Pjesëmarrëse në këtë punëtori do të jenë gratë nga partitë e ndryshme si dhe gratë nga shoqëria civile që janë të interesuara të garojnë për zgjedhjet lokale. Punëtoritë kanë filluar me datat 27-28 mars 2017 në Prizren dhe gjatë muajit prill janë mbajtur në të gjitha komunat tjera
- AKK-ja zhvilloj takim me Policinë e Kosovës, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta për zbatimin e Ligjit për Kundërvatje në fokus ishte çështja e inkasimit mjeteve materiale nga gjobat mandatore të trafikut, në teritorin e komunave të Kosovës, e që në ditët në vijim do të pasojnë takimet tjera me strukturat e AKK-së për rregullimin e çështjes në fjalë
- Kolegjiumi i Menaxherëve të Personelit ka shqyrtuar tri projekt-rregulloret e Ministrisë së Administratës Publike, të cilat kanë të bëjnë me rregullimin e fushës së menaxhimit të personelit dhe ka dhënë komentet të cilat duhet të inkorporohet për shkak të specifikave që ka shërbimi civil në nivelin lokal: projekt rregullore nr. 01/2017 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil; projekt rregullore nr. 02/2017 për procedurat disiplinore në shërbimin civil; projekt rregullore nr. 03/2017 për procedurat e zgjedhjes së kontesteve dhe ankesave
- Kolegjiumi i Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar dhe ka dhënë komente në: “Projekt Udhëzimi Administrativ për Përcaktimin e Procedurave për Dorëzimin dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore si dhe për Leje Ndërtimore për Kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve; “Projekt udhëzimi administrativ për mbikëqyrje inspektive dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit”

Kryesuesit e Kuvendeve të Komunave identifikojnë nevojat për këshilltarët e ardhshëm komunal



Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoj një takim dyditor për Kolegjin e Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave. Qëllimi i këtij takimi ishte identifikimi i nevojave për organizimin e trajnimit të anëtarëve të rinj të Kuvendeve të Komunave të cilët do të dalin nga zgjedhjet lokale të fundvitit 2017.



Ky vlerësim i nevojave është bërë duke pas për bazë edhe përvojën e deritashme dhe sfidat nëpër të cilat kanë kaluar Kuvendet e Komunave. Në këtë takim dyditor morën pjesë Kryesuesit e Kuvendeve të Komunave të Kosovës si dhe stafi i AKK-së.

Plan pune për fuqizimin e Transparencës nëpër Komunitet e Kosovës



Nën organizim të Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe me mbështetjen e OSBE, është organizuar takim dy ditor i Kolegjit për Transparencë. Në këtë takim përfaqësuesit e komunave në këtë Kolegjin kanë hartuar dhe miratuar

Planin Vjetor të Punës. Ky plan parasheh disa masa dhe aktivitete, edhe përmes lobimit, për të rritur dhe fuqizuar transparencën në Komunitet e Kosovës si njëra ndër hallkat e qeverisjes së mirë.

Poashtu Kolegji për Transparencë ka debatuar edhe për obligimet ligjore që kanë komunitet, duke inkorporuar gjithë sektorët komunal, në avancimin e respektimit të plotë të akteve ligjore që ndërlidhen me transparencën ndaj publikut.

Kolegji për Transparencë në bashkëpunim me përfaqësuesin e DEMOS-it kanë debatuar dhe përcaktuar kriteret e kornizën për nxjerrjen e një dokumenti në formë analize lidhur me parimet bazë dhe rekomandimet për Transparencën në Komunitet e Kosovës.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

BULETINI

Viti XIV. Nr. 83 • Mars - Prill 2017

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacioni i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

